

Shenjat e trafikut dëmtohen nga predhat e armëve, policia sekuestron 40 gëzhoja dhe tre fishekë



13/04/2025 08:56

f

tw

ig

Policia e Kosovës, përmes raportit 24 orësh, ka njoftuar se janë informuar se shenjat e trafikut në Zllash të Prishtinës janë dëmtuar.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë policia dhe ka vërejtur se shenjat e trafikut janë dëmtuar nga predhat e armëve.

Aty janë gjetur 40 gëzhoja kalibrash të ndryshëm dhe tre fishekë.

“PËRDORIM I ARMËS- Fsh. Zllash, Prishtinë NN. Më 12.04.2025 ankuesi mashkull kosovar, ka njoftuar policinë se shenjat e trafikut janë të dëmtuara. Njësia policore ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vërejtur se shenjat e trafikut janë të dëmtuara nga predhat e armëve dhe në afërsi të shenjave janë gjetur 40 gëzhoja kalibrash të ndryshëm dhe tre fishekë. Gëzhojat dhe fishekët janë sekuestruar nga njësia e hetuesisë. Nuk raportohet për të arrestuar. Rasti në hetime”.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LaptopMedia



Artikuj të ngjashëm



April 13, 2025
Ramabaja: Të hënën bëhet publik koalicioni formal VV – NISMA



April 13, 2025
Parashikimi i motit për javën e ardhshme



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrra nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information